

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga Agim Xhafka - Dialog me mbesën
ADRESA	https://www.syri.net/op-ed/916002/dialog-me-mbesen/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 15:35:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 shtator 2026, 15:28:45 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d4c5e262b15347f67836fccbce3b6a839bc7bb200a325de15067f97dbe43ea0b
TEKSTI	dff6d1f25f690a5444ebedad0e6885eac162e3ecbe6ed32ad8765aa0994496be
PAMJA	b426329722905987ec0816a1b98a4695a44ef53f67a5f130244669a13005084a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9e28d45e5725d90b32cf14f670099c4f97ff39a40ff73a20df9f220c1157ae34
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	ab892af2d9e792fa00a607397de5c726b18c8487fd3face12e7f3de998a653a0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9e28d45e5725d90b32cf14f670099c4f97ff39a40ff73a20df9f220c1157ae34>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AGIM XHAFKA
Dialog me mbesënNDRIM KULLA
Shoqëria shqiptare, duhet të fillojë betejën me heshtjen e SPAK-ut

Dialog me mbesën



Nga Agim Xhafka - 17:28, 11/09/2026

Dje mes minutave të një dremitje dreke më ra zilja e celularit. I hodha një gjysëm sy sa për të ditur kush qe se meazallah do e hapja. Por më doli 'Jeta ime', kështu ia kam vënë emrin në telefon mbesës. E hapa vrik.

-O gjysh, a të të bëj ca pyetje? Se filluam shkollën e kam një projekt.

Nga që unë përherë them po s'priti përgjigje, ia nisi.

-Keni pasur ju të drejta themelore para viteve '90? Në kohën e diktaturës dmth?

-Po, mi gocë kemi pasur. Kemi pasur plot, plot,-i thashë.

Dhe po mendoja me këtë rast të bëja një bisedë me kuptim për ato mote tmerri. Që mbesa të ndërtonte peizazhin social ku jetuam. Ajo është adoleshente dhe do shpjegime konkrete, me shembuj, si psh kur i sqarova një ditë inflacionin. I tregova një garuzhde me vrëma dhe i thashë, këtë do e mbushim me supë. Po supa do të rrjedhë, tha ajo. Sigurisht dhe pjesa që rrjedh është inflacioni, supa që ngelet është rroga reale e shqiptarëve. Kështu ia ngulita në tru.

-Ia nisim me të drejtën e lëvizjes. E keni pasur ju këtë të drejtë? -më bëri pyetjen e parë.

-Po, e kemi pasur. Nuk na ndalonte askush të ecnim psh nga kuzhina në banjë. Ose anasjelltas. Lëviznim pa i marrë leje kujt dhe fare pa vizë.

-O gjysh, mos u tall tani! A shkonit jashtë atdheut e kisha fjalën?

-Si nuk shkonim, moj, kudo bridhnim nëpër glob,-i thashë. -Kishte televizioni ynë një emision 'Vende dhe Popuj'. Na tregonte të gjithë shtetet e botës. E vërteta qe që më shumë 'lëviznim' në Afrikë. Ende e di në pëllëmbë të dorës psh Angolën, Nigerinë, Kongon.

-O gjysh, po mos u tall të thashë! Pasaporta shqiptare ato vite çfarë ngjyre kishte?

-Kishte ngjyrë patjetër. Me ngjyrë ishte. Po ja të pyes Bedriun e të them.

-Pse ti nuk e mban mend?

më të lexuarat



Tensionet diplomatike Algeri – Emiratet e Bashkuara Arabe: Realiteti i ri i një marrëdhënieje të stuhishme



'Mbështetja është e kushtëzuar': Ambiciet mbrojtëse të Evropës përplasen me shtrëngimin ekonomik



Sezon i ri, probleme te vjetra



Interesat e përbashkëta ringjallin miqësinë midis Trump dhe Putin



Në Shtetin e Ronit!



16 Shtatori, Dita e Drejtësisë apo dita që (s)mund ta tronditë Kosovën?



25 vjet pas 11 Shtatorit: çfarë zbulojnë katastrofat për aftësinë e amerikanëve për t'u rilidhur

-Nuk e mbaj mend se gjithë populli nuk kishte pasaporta. Bedriu kishte se punonte shofer në ambasadë në Romë.

-Po të drejta banimi a kishit ju?

Ajo lexonte në libër një për një të drejtat e njeriut dhe më pyeste mua.

-Kishim si jo, se ne nuk flinim jashtë ose nëpër pemë si majmunët.

-Në sa metër katror jetoje o gjysh deri sa bleve këtë shtëpi ku je tani?

-Në pak metër, bijë. Konkretisht banesa ishte aq sa kemi sot dy garazhet te kati poshtë në pallat.

-O gjysh, mos u tall! Po fundjavave si argëtoheshit, nga shkonit?

-Në fshatra zemër, në fshatra. Çdo të dielë, nuk mungonim kurrë. Bridhnim çdo javë fup këtu e fup atje.

-Te cilët restorante, a kujton ndonjë?

-Më shumë frekuentonim restorantin 'Misri', pub 'Patatja' dhe bar-kafe 'Kanali'.

Por nuk e lashë të pyeste ku qenë konkretisht këto lokale. I shpjegova që e shtuna atëherë s'qe pushim. Dhe shkollat bënin mësim atë ditë. E diela quhej pushim, por në fakt na çonin në aksion për korrije dhe zhveshje misri, për hapje kanalesh ose për shkulje patatesh. Heshti ca sekonda. Po e ndërtonte në përfytyrimin e saj atë kohë ndaj më bëri pyetjen e fundit:

-Po mirë, ju nuk kishit asnjë të drejtë? Asnjë?

Heshta punë sekondash. Po mendoja që t'i jepja një përgjigje me brumë. Dhe e gjeta.

-Kishim, kishim një të drejtë të madhe që si popull e shfrytëzuam shumë, për asnjë çast nuk e harruam.

-E cila qe?

-Qe e drejta për të heshtur. E zbatuam me përpikmëri, si sahat zvicerian.

Nuk vazhdova ligjëratën, ajo e kishte mbyllur celularin. Ndaj atë çast mbylla sytë dhe unë e kujtova gjysmën e jetës sime. Atë gjysëm që vite e nëpër vite mora frymë me gojën mbyllur...

© SYRI.net

Lexo edhe

» Tensionet diplomatike Algjeri – Emiratet e Bashkuara Arabe: Realiteti i ri i një marrëdhënieje të stuhishme

» Kush po voton për Alternativën për Gjermaninë, partinë e ekstremit të djathtë?

» 25 vjet pas 11 Shtatorit: çfarë zbulojnë katastrofat për aftësinë e amerikanëve për t'u rilidhur

Komentet

Shto koment

Emri

Shkruani komentin tuaj

Posto



Kush po voton për Alternativën për Gjermaninë, partinë e ekstremit të djathtë?



Shoqëria shqiptare, duhet të fillojë betejën me heshtjen e SPAK-ut

TË NGJASHME



Interesat e përbashkëta ringjallin minësinë midis Trump dhe Putin



'Mbështetja është e kushtëzuar': Ambicijat mbrojtëse të Evropës



Shoqëria shqiptare, duhet të fillojë betejën me heshtjen e SPAK-ut



Në Shtetin e Ronit!

përplasen me shtërëgimin ekonomik



Sezon i ri, probleme te vjetra



Ambiciet e Turqisë vënë në provë
interesat amerikane



16 Shtatori, Dita e Drejtësisë apo dita
që (s)mund ta tronditë Kosovën?

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MËDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.